



Në bazë të Nenit 28 të Vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e ndarjes së mjeteve për organizatat joqeveritare ("Fleta zyrtare e MZ — dispozitat komunale", nr. 046/19,010/21 , 016/21), komisioni për ndarjen e mjeteve shpall,

## FTESË PUBLIKE

### Për zgjedhjen e vlerësuesve të pavarur të propozimit të projekteve për Vitin 2023

Ftesa publike për zgjedhjen e vlerësuesve të pavarur shpallet me qëllim të vlerësimit të projekteve të organizatave joqeveritare.

Vlerësuesi i pavarur mund të jetë një person i cili ka:

- Së paku pesë vite përvojë në shkrimin dhe zbatimin e projekteve;
- përvojë në vlerësimin e projektit;
- të paktën pesë vite përvojë në punë në së paku një fushë të specifikuar sipas këtij vendimi për të cilin po aplikon që të vlerësojë propozimet e projektit;

Vlerësuesi i pavarur nuk mund të jetë personi i cili dy vite para shpalljes së ftesës publike ka qenë:

- i punësuar në një organizatë joqeveritare me seli në Tuz;
- i angazhuar (me kontratë pune, vullnetar) në punën e një organizate joqeveritare me seli në Tuz;
- person i autorizuar për të përfaqësuar apo anëtar i organit drejtues ose një organi tjetër i një organizate joqeveritare, selia e së cilës është në Tuz;
- funksionar lokal, nëpunës gjegjësisht punonjës, i punësuar në institucione publike dhe ndërmarrje të themeluara nga vetëqeverisja lokale apo këshilltar.

Kandidati për vlerësues të pavarur duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- një biografi që përshkruan përvojën në shkrimin dhe zbatimin e projekteve;
- një deklaratë që ai / ajo nuk ka qenë i angazhuar (me kontratë pune, vullnetar) në punën e një organizate joqeveritare me qendër në Tuz për të paktën dy vite para se te aplikonte për vlerësues të pavarur të propozimeve të projekteve;
- një deklaratë se ai nuk është anëtar i organit drejtues të një organizate joqeveritare me seli në Tuz;
- një deklaratë që ai/ajo nuk është një funksionar lokal, nëpunës gjegjësisht punonjës, i punësuar në institucione publike dhe ndërmarrje të themeluara nga shteti ose vetëqeverisja lokale, deputet ose këshilltar.

Detyra e vlerësuesve të pavarur është:

- vlerësimi dhe propozimi i projekteve;
- plotësimi i listës për vlerësimin e propozimeve të projekteve;
- paraqitja e një liste të propozimeve të projekteve që do të mbështeten nga Komisioni.

Ftesa publike për zgjedhjen e vlerësuesve të pavarur publikohet në faqen zyrtare të Komunës, tabelën e njoftimeve të Komunës, përmes transmetuesit publik lokal dhe në një mënyrë tjetër të përshtatshme për një periudhë prej 15 ditësh.

Komisioni vendos për numrin dhe përzgjedhjen e vlerësuesve të pavarur.

Nëse vlerësuesi i pavarur nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në Ftesën publike ose nuk e paraqet kërkesën brenda afatit të përcaktuar, aplikimi i tillë nuk do të merret në konsideratë. Formulari i aplikimit me dokumentacion të plotë dorëzohet në një zarf të mbyllur në Arkivin e Komunës.

Emrat e vlerësuesve të pavarur publikohen në faqen zyrtare të Komunës së Tuzit brenda 10 ditëve nga dita e përfundimit të Ftesës publike.

**KRYETARJA E KOMISIONIT**

Marina Ujkaj



*(Handwritten signature)*